

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 21.12.2024*

21.12.2024

Ora 12:44

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Komisioni Rregullator:
- Ilirjana NANO Kryetar
- Arens ÇELA Anëtar
- Dritan ÇAKA Anëtar
- Helga VUKAJ Anëtar
- Muharrem ÇAKAJ Anëtar
- Stafi KQZ Znj M. Çelmeta, znj. P. Doçaj
- Parti Politike: S’ka prezent
- OJQ: KRIIK

Znj. I. Nano: Mirëdita! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, Sekretarja e Përgjithshme dhe zyrtarë të tjerë të administratës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësues nga shoqëria civile, konkretisht nga organizata KRIIK dhe media. Në rendin e ditës të mbledhjes së sotme, sikundër theksuam dhe në mbledhjen e ditës së djeshme kemi një projektvendim.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 21.12.2024*

ndryshimet e nenit 9, të vendimit nr. 9, ku përcaktohet mënyra e shqyrtimit dhe raportimit dhe ndalimet e veprimeve publike. Në mënyrë më të detajuar do të doja që fillimisht të filloja me përcaktimin e frazës NRI, që është “Ndërfaqja elektronike e raportimeve të institucioneve publike”, e cila ndërtohet dhe shërben sipas përcaktimeve të nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Të dhënat mbi aktivitetet publike të administratës shtetërore apo të institucioneve publike do të duhet të jenë të aksesueshme, pra “open data” dhe për këdo dhe për të tretët, direkt nga kjo ndërfaqe, duke patur mundësinë e prodhimit të raporteve përkatëse. Informacioni që përmban NRI është i aksesueshëm që nga momenti i hedhjes të të dhënave deri në ditën e shfaqjes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Raportimi në NRI është një veprimtari publike, për një veprimtari publike të caktuar dhe do të duhet të bëhet jo më vonë se pesë ditë përpara datës së planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë, raportimi bëhet për veprimtari të cilat organizohen ose bashkëorganizojnë nga institucioni publik raportues, nuk raportohen veprimtari ku institucioni publik apo përfaqësues të tij janë thjesht pjesëmarrës. NRI mund të lejojë raportimin e një veprimtarie e cila nuk plotëson kushtin e afatit pesë ditor të cilit, të cituar si më sipër, por automatikisht kjo veprimtari përcaktohet si e ndaluar për sa kohë KSHZ nuk ka marrë një vendim për ta lejuar atë. Raportimi mund të mbajë dhe do të duhet të përmbajë datën dhe orën e zhvillimit të veprimtarisë, qarkun, bashkinë adresën ku ajo zhvillohet, llojin e saj, tematikën e veprimtarisë, emër mbiemër të personave pjesëmarrës të cilët përfaqësojnë nivelin më të lartë hierarkik shtetëror në aktivitetin përkatës, institucionin të cilit i përkasin, emër mbiemër të folësve të mundshëm dhe pozicionin e tyre, me pjesëmarrje të medias ose jo, pasqyruar në rrjete sociale, median online, ose jo. Të dhënat e raportimit nuk mund të modifikohen në periudhën 5 ditë përpara datës së zhvillimit të aktivitetit deri në datën e zhvillimit të tij. Ajo që bën KQZ-ja në shqyrtimin e

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 21.12.2024*

këtyre raportimeve, të cilat i merr në shqyrtim jo më vonë se 3 ditë nga raportimi i tyre në ndërfaqe. Në rast se KQZ, kryesisht ose me kërkesë të palëve të treta, konstaton se veprimtaria ose aktiviteti përbën veprimtari të ndaluar, urdhëron ndalimin e zhvillimit të veprimtarisë së aktivitetit publik përkatës. Ndalimi kryhet nëpërmjet vendosjes së shënimit “Ndaluar nga KQZ-ja” në NRI dhe ua përcjell automatikisht institucionit në llogarinë e tij në NRI. Automatikisht i shkon institucionit dhe ndër të tjera KQZ për këtë veprimtari lajmëron pra AMA-n ashtu siç e ka dhe të përcaktuar në Kodin Zgjedhor. Në mënyrë të përmbledhur këto janë pak a shumë specifikimet të cilat përmban projektvendimi. E sjellim për shqyrtim përpara jush duke pasur kompetencën për të shqyrtuar këtë projektvendim. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Doçaj! Kolegë keni diçka paraprakisht? Ndërkohë kemi dhe përfaqësuesen e organizatës KRIK që kanë sjellë disa mendime me shkrim. Dëshironi ju së pari në parim, keni diçka në parim për këtë projektvendim? Po zonja Vukaj.

Znj. H. Vukaj: Faleminderit zonja Nano! Në vijim të dinamikave që pësoi ky proces formalo-procedural, më lejoni të sjell në vëmendje që akti ose draftiakti i sotshëm dhe çfarë ne kemi në tryezë për shqyrtim, është një projektpropozim i cili vjen jo më si rishtar, pra është një propozim i cili bazohet në kërkesën tonë për akomodimin e shqetësimeve që KQZ dhe Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nxori në kuadër të marrjes së masave përpara zhvillimit të zgjedhjeve të vitit 2025. Problematika që ai nxori u reflektua në relacionin e ardhur dje dhe sot që sërish unë e gjej tashmë pjesërisht të paplotë sepse dje konstatoi që ishte tërësisht i paplotë. Relacioni përmban disi më shumë argumenta, po përsëri nuk na jep

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 21.12.2024*

panoramën e qartë se çfarë konkretisht kolegët e KAS-it kanë evidentuar në raport me kategorinë e institucioneve të cilat mbartin dhe kanë përgjegjësinë e raportimit, sigurisht përmes personave përgjegjës dhe së dyti panoramën apo problematikat që ata kanë nxjerrë në raport me veprimtaritë e ndaluara të cilat ose janë keqshtruar ose janë abuzuar, është abuzuar me to nga ana e institucioneve me qëllim ndikimin e një partie, të një kandidati apo të kandidatëve të ndryshëm në qarqe të ndryshme. Për këtë arsye mbrëmjen e djeshme, menjëherë pasi ka ardhur relacioni me draftin e ripunuar, jemi drejtuar sigurisht administratës për dijeni edhe Komisionerit, për përmirësimin jo vetëm të draftit dhe akomodimin në draft të pikave të cilat nuk i gjenim të përshtatura sipas nevojës së tyre, por njëkohësisht edhe për relatimin e disa momenteve të cilat janë shumë sensitive, ashtu siç është dhe vetë përmbajtja e këtij akti, për hir të të dhënave dhe për hir të institucioneve që duhet të marrin përgjegjësinë për të raportuar, është një proces shumë sensitiv dhe me shumë impakt për zgjedhjet parlamentare të këtij viti, pra viti që do të vijë. Në këtë kuadër ne pamë se relacioni ishte, nga ana formale nuk kishte firmën dhe ky është një moment jo crucial por moment për t'u përmbushur dhe kjo u përmbush. Ne pamë që në relacion na thuhej që KAS-i, organi tjetër drejtues ka evidentuar disa problematika por ende problematikat nuk na kanë ardhur, në qoftë se dikush prej jush, nga administrata ka dijeni për këto lloj problematikash mund t'i ezaurojmë edhe sot mbasi unë të mbaroj fjalën. Tjetër, pamë që raportohet që në vitin 2021 kemi një sensibilizim nga ana e institucioneve, pothuajse pjesorë do ta quaja sepse kjo kërkon një analizë të detajuar ku në ndërfaqe janë regjistruar pothuajse 355, në mos gabo, institucione. Natyrshëm këtu lind pyetja, a keni një analizë ju si KQZ, që sa nga totali i institucioneve publike në këtë vend mbartnin detyrimin për t'u regjistruar dhe për të proklamuar apo për të njoftuar KQZ-në për veprimtarinë e tyre, e cila ishte sensibilitet dhe mendohej që do të ndikonte në procesin zgjedhor,


*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 21.12.2024*

pra sa duhet të ishte numri në të vërtetë që do të regjistroheshin, nga këto që u regjistruan, pra 355 të tilla, sa hodhën në ndërfaqe realitetin mbi këto veprimtari, pra sa e plotësuan ndërfaqen me sinqeritet dhe objektivitet, sa të tjera e plotësuan atë pjesërisht, pra njoftuan veprimtari pjesërisht dhe sa prej tyre i plotësuan më vonë nga afati pesë ditor? Përpos kësaj analize të cilën nëse e keni sot na e shfaqni sot ose na e relatoni sot, nëse s'e keni na bëni një përmbledhje ku t'u shpërndahet jo vetëm kolegëve por edhe, sepse ka shumë sensibilitet në këtë pjesë dhe do na duhet dhe për vijimin e aktit, me ndryshimet e tjera. Thoni se në vitin 2023 paska pasur një sensibilitet edhe më të madh, pra akti ka dhënë efekt më shumë dhe ka sensibilizuar më shumë dhe numri rritet nga 355 institucione që deklaruan veprimtarinë e tyre gjatë kësaj fushate në 716, pra diferenca është 361 institucione. Çka do të thotë që në këtë rast përsëri këtë e nxjerr analiza, kishte një sensibilizim më shumë, kishte institucione që u angazhuan me veprimtari më shumë, këto institucione a hodhën në ndërfaqe, në mënyrë objektive të gjithë veprimtarinë që zhvilluan? A e hodhën atë brenda afatit dhe në të njëjtën kohë, paralelisht me këtë analiza do të duhet të vijojë dhe duhet të kemi një informacion që sa raste ndëshkoi KQZ-ja nga institucionet, të cilat nuk e konsideruan ndërfaqen, pra nuk ushtruan njoftimin e veprimtarive të tyre, nuk e respektuan afatin ose e respektuan ndërfaqen pjesërisht? A keni ju një analizë dhe përgjigjen e dua pas fjalës sime. Nga ana tjetër gjëj të plotësuar disa paragrafë ose disa pika të cilat ishin në draftin fillestar dhe janë transpozuar apo përcjellë në këtë draft që na ka ardhur sot, siç ishte gërma "f" e propozuar më herët apo pika 6 e kështu me radhë. Ka momente të tjera të cilat, e nderuar zonja Nano unë mendoj që t'i propozoj gjatë shqyrtimit të aktit, por këto janë si fillim dhe ndërkohë unë prisja pas emailit të dytë që dërguam bashkë me kolegun Çakaj, me shumë shqetësim ia adresuam Komisionerit, prisja që rolin e Komisionerit ta bënte vetë Komisioneri sepse na

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 21.12.2024*

dalin shumë problematika dhe shumë pikëpyetje për të cilat ju ndoshta s'keni dijeni, ndoshta nuk mund të merrni kompetencën e tij dhe ndoshta është një gjë tejet individuale e Komisionerit si mbajtës i tagrave të marrëdhënieve, të ushtrimit të marrëdhënieve me të tretët. Pse e them këtë? Kjo ka lidhje me kërkesën tonë të mëhershme, pra ditën e djeshme ne e kthyem draftin për ta ripunuar dhe përmirësuar nga ana juaj por në sintezë të plotë me dy nenet dhe dy detyrimet që dalin nga neni 91 i Kodit Zgjedhor dhe neni 92 i Kodit Zgjedhor, ndryshimet e sotme pasqyrojnë vetëm nenin, përmirësimin e kushteve për zbatimin më mirë të nenit 92, por nuk sjellin zbatimin më mirë të nenit 91, i cili është një nen shumë fragjil dhe një nen nga i cili impaktohet, padiskutim fushata zgjedhore dhe prevalimi i kandidatëve në garë me kandidatë të tjerë të cilët ndoshta nuk kanë potencialin t'i mbështesin institucionet publike, buxhete të caktuara, asete të caktuara apo burime njerëzore të caktuara, të cilat vinë nga administrata. Në këto kushte jam e detyruar të deklaroj që unë nuk e pashë ndryshimin e vendimit nr.9 për sa i përket nenit 91 dhe për këtë i kemi kërkuar bashkë kolegun Muharrem Çakaj, Komisionerit që atë shpërfaqje publike, apo atë çfarë ju relatuat dje që Komisioneri është duke punuar me grupet e interesit, partitë politike etj., dhe duke diskutuar për ta, në lidhje me përmirësimin dhe rregullimin e standardit në raport me pjesën e parë të vendimit 9, pra i ka lënë të kuptohet dhe ju latë të kuptohet që këto do të ndryshohen në vijim, do të doja sot të kisha një deklaratë të tijën që po, ne po marrim përsipër të akomodojmë dhe të rregullojmë më mirë, ta bëjmë më efektive ndërfaqen duke sjellë përmirësim për hir të nenit 92 por unë do të doja deklaratën e tij dhe në qoftë se ju e keni mund ta proklamoni, për akomodimin më mirë dhe përmirësimin e situatës dhe bërjen efektive të detyrimeve që rrjedhin nga neni 91 i Kodit, pra vendimi 9 duhet të bëhet i plotë njëherë e përgjithmonë duke sensibilizuar masivisht institucionet publike që “stop” përdorimit të të mirave

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 21.12.2024*

publike, aseteve publike, buxhetit dhe çdo burimi tjetër administrativ për hir të fushatës dhe për hir të kandidatëve të caktuar dhe një partie të caktuar. Nëse të gjitha këto pyetje ju m'i ezauroni tani, unë do të isha shumë e kënaqur për të vazhduar procesin e shqyrtimit më tej të këtij akti. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Vukaj! Zonja Doçaj diçka për komentet, pyetjet e zonjës Vukaj.

Znj. P. Doçaj: Po, ta fillojmë që nga pyetja e parë, në lidhje me analizën apo me statistikat që janë mbajtur nga ana e drejtorisë përkatëse, mund të themi që kemi gjatë gjithë kohës janë zhvilluar analiza të tilla në KQZ dhe kemi disa të dhëna në lidhje me administrimin e denoncimeve që kanë qenë sidomos për periudhën e zgjedhjeve të 14 majit 2023. Nëse doni unë mund t'u jap të dhëna sot sepse i kam, nëse doni një analizë më të thelluar, ku të detajohen të gjitha, pra sa janë nga subjektet politike, sa nga komitete apo OJF të ndryshme, sepse i kemi të dhënat dhe i kemi të ndara se nga kush vinë këto denoncime fillimisht. E dyta në lidhje me faktin që keni pasur një ndërgjegjësim të institucioneve ndër vite, patjetër që vendimi nr. 9, i Rregullatorit është perceptuar ndryshe në, apo është përqaftuar ndryshe në 2023, ka pasur ndërgjegjësim të institucioneve, ka pasur ndërfaqja hapje të llogarive për 300 institucione më shumë, kjo nuk do me thënë që të gjitha institucionet kanë pasur veprimtari publike për të raportuar, kështu që nuk mund të kemi një analizë të qartë se pse nuk e kanë raportuar apo në rastet kur janë konstatuar që nuk e kanë raportuar dhe ka ardhur një denoncim nga një OJF apo nga një monitorues, siç ne e kemi për periudhën zgjedhore, patjetër që është administruar dhe është adresuar më pas duke marrë masa administrative që janë lënë fuqi dhe nga KAS dhe pikërisht nga këto janë nxjerrë dhe problematikat e

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 21.12.2024*

këtij Komisioni, kështu që nuk besoj që është ndonjë e dhënë e cila ne na bën që të analizojmë se cilat janë ato institucione që realisht nuk janë ndërgjegjësuar për të raportuar, pra 361 institucione më shumë nga 2021, po janë, por të gjitha këto nuk kanë pasur apo një pjesë e mirë e tyre nuk kanë pasur veprimtari...

Znj. I. Nano: Pa të ndërprerë, të të bëj një pyetje zonja Doçaj, për çdo palë zgjedhje besoj që përditësohet lista e institucioneve?

Znj. P. Doçaj: Po dhe në këtë rast ne kemi, në datën 18 dhjetor ne jemi drejtuar institucionit kompetent për përditësimin e listës, nuk e kemi akoma një përgjigje por normalisht do të duhet patjetër që brenda një afati të shkurtër do ta kemi këtë para se të fillojë.

Znj. I. Nano: Para se të fillojë afati i raportimit.

Znj. P. Doçaj: Para datës 11 janar do të duhet që të jetë lista e përditësuar e këtyre institucioneve. Në lidhje me ndryshimet apo adresimet e nenit 91, ne sot jemi pikërisht për disa ndryshime në rregullat e raportimeve të veprimtarive të institucioneve, të adresuara të shqetësimit që kemi neni 92, në aplikim të nenit 92. Në lidhje me pjesën tjetër, po patjetër që është duke u punuar por nuk, sot nuk kemi ndryshime apo adresime të këtij neni, jemi pikërisht vetëm për adresimet e shqetësimit që ka neni 92 ose më saktë më shumë për të definuar këtë ndërfaqen që do të na duhet dhe e kemi detyrim ligjor për ta implementuar.

Znj. H. Vukaj: Pra po na lë të kuptojmë që sot nuk mundeni për shkak se ende po punohet dhe kemi një deklaratë ose një deklaram nga Komisioneri që në ditët në

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 21.12.2024*

vijim do të kemi ndryshimet të pasqyruara dhe të propozuara sërish prej tij para datës 11 janar?

Znj. P. Doçaj: Jo nuk e kam, nuk e kam të, nuk është një gjë që po them unë këtë që ta kemi në ditët në vijim, nuk e di se kur do ta kemi këtë dhe nëse do ta kemi por di që jemi duke punuar për të adresuar edhe këto shqetësime, pra të nenit 91.

Znj. H. Vukaj: Zonja Sekretare e Përgjithshme, ju keni ndonjë dijeni që Komisioneri ka sensibilitetin që të sjellë pas punimit dhe marrëdhënieve që ai mban me të tretët në drejtim të përmirësimit të situatës për nenin 91?

Znj. M. Çelmeta: Deri në këtë moment, mund të them që nuk e kam një informacion të tillë, po me besimin që do të ketë një informacion nga ana e tij, patjetër.

Znj. H. Vukaj: Mund t'ia merrni të lutem Komisionerit dhe të na e proklamoni në mbledhje?

Znj. M. Çelmeta: Do ta diskutojmë.

Znj. H. Vukaj: Jo gjatë mbledhjes, tani, gjatë kësaj mbledhje të lutem sepse Komisioneri do të duhet të ishte vetë në fakt, po kjo na bën që të bëjmë këto urat përmes jush dhe jo për fajin tonë.

Znj. P. Doçaj: Nuk besoj që do të kishte ndonjë deklaratë tjetër Komisioneri përveç kësaj që unë thashë, që unë citova, pra që është duke u punuar por nuk kam

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 21.12.2024*

asnjë datë apo ditë të caktuar, apo orë të caktuar që kur mund të vinë këto propozime.

Z. M. Çakaj: Më falni, atëherë ju konfirmoni që nga ana e administratës së KQZ-së dhe nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve po punohet për adresimin e shqetësimeve në vendimin nr. 9 për sa i përket veprimtarive të ndaluara, e konfirmoni këtë gjë, që po punohet. Pastaj tjetër histori se kur paraqitet, si paraqitet, ky është një vendim i cili patjetër ka nevojë për dakordësi, e në mungesë të arritjes së një dakordësie, sigurisht që neni 20, në mos gaboj neni 12 i Kodit Zgjedhor parashikon kompetencën e një apo dy apo disa anëtarëve të Komisionit Rregullator ta propozojë, por thelbi i pyetjes është që ju po punoni me këtë, pra ka një angazhim nga ana e KQZ-së dhe KSHZ-së lidhur me këtë.

Znj. P. Doçaj: Nga ana e KSHZ-ka një angazhim në lidhje me këtë, sapo thashë, atë që sapo thashë më parë.

Z. M. Çakaj: Qartë.

Znj. H. Vukaj: E keni parasysh që afati i fundit që duhet të jetë paketa, data 11 janar 2025, se pastaj le të punoni gjithë ditën! Problemi është që kjo të ezaurohet brenda afatit, 11 janar, mundësisht të lutem merrni një konfirmim edhe pse zonja Doçaj e di me bindje këtë gjë, unë do të doja dhe një konfirmim tjetër në vazhden e emailit, që po, po punojmë dhe do të sjellim ndryshimet para kësaj date.

Znj. I. Nano: Dakord, vazhdojmë, nga KRIIK-u, Anduela keni diçka para se të fillojmë shqyrtimin, jemi në diskutimin në parim të projektvendimit?

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 21.12.2024*

Znj. A. Male, përfaqësuese e KRIIK: Përshëndetje, faleminderit! Në fakt nëse do të bëja shumë shkurt një kronologji, ne kemi marrë ftesën për të kontribuar me rekomandimet tona që në momentin kur po punohej për ndërtimin e ndërfaqes të raportimit të institucioneve. Lidhur me këtë ndërfaqe kemi çuar rekomandimet tona teknike po jo vetëm, të gjitha të bazuara në të gjithë procesin tonë të monitorimit lidhur me abuzimin me burimet shtetërore elektorale. Në vitin 2023 numri i institucioneve që janë shtuar në data bazën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka qenë edhe për shkak të numrit të lartë të denoncimeve të përcjella nga organizata të shoqërisë civile dhe nga ne, lidhur me aktivitete të paraportuara. Ajo që ne gjykojmë shumë të rëndësishme është pjesa e, përveç të gjitha rekomandimeve teknike që tanimë janë akomoduar në projektaktin e sjellë nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, janë disa elementë të tjera, të cilat ua kemi paraqitur edhe me shkrim në kohën më të parë të mundshme, duke qenë qartë që vetëm dje në darkë i dërguar me email dhe parë në këndvështrimin që tanimë po preken vendimi nr. 9 dhe nuk është një akt më vete, vetëm sa i përket ndërfaqes së raportimeve, por elementët që ne gjykojmë që nuk janë përfshirë në projektaktin e përcjellë tanimë dhe të propozuara nga ne edhe në aktin e parë të administratës së KQZ-së ka të bëjë me, nuk e di ndoshta duhet tua them në mënyrë të përgjithshme, ndoshta do të duhet që të sqaroj çfarë është shkruar në atë dokument me rekomandime të përcjellë, më thoni ju se si e keni më të përshtatshme të gjithë ndërtimin.

Znj. I. Nano: Jemi në fazën e diskutimit në parim, kur të vinë nenet përkatëse, në këtë fazë

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 21.12.2024*

Znj. A. Male, përfaqësuese e KRIIK: Unë, sigurisht secilin, por ndarja e qëllimit të aktivitetit, ndarja e institucioneve pjesëmarrëse në aktivitet, ndarja ndaj personit përgjegjës të raportimit me personin që kryen në fakt mekanikisht të gjithë raportimin në ndërfaqe si dhe organizimi i gjithë NRI-së, si një aneks ku të përfshihet çdo detaj teknik dhe mundësisht ta zgjidhim dhe të mos lihet në diskrecion në momentin e ndërtimit të kësaj ndërfaqeje, ne konsiderojmë që janë shumë të rëndësishme përmbledhtazi në parim. Sigurisht që nëse do të ketë diçka në diskutimet tuaja të mëtejshme, patjetër që jam këtu për sqarim. Faleminderit!

Znj. I Nano: Faleminderit! Po zoti Çakaj.

Z. M. Çakaj: Atëherë, së pari vlen të theksojmë që ky projektakt është vetëm një ndryshim pjesor i vendimit ekzistues nr. 9, i cili ka lindur si nevojë i gjithë problematikës së hasur nga zgjedhjet e vitit 2021 deri më sot. Së dyti ky projektakt vjen si pasojë, nga sa është bërë e ditur nga dje deri sot, vjen si pasojë e faktit që aktualisht në KQZ nuk funksionon faqja e raportimit, ndërfaqja e raportimit dhe ne po krijojmë edhe me ndimën e Këshillit të Europës, një ndërfaqe të re për të adresuar dhe problematikat e vjetra, por dhe për të përmirësuar proceset. Sjellim në vëmendje të gjithë palëve të interesuara, së pari tonin dhe palë të tjera të interesuara si të partive politike, si të mediave, si institucioneve publike, të cilat janë subjekte të zbatimit të këtij vendimi, por po ashtu edhe të denoncuesve ku këtu një meritë të veçantë kanë dhe organizatat e shoqërisë civile, të cilat monitorojnë kryesisht kanë objekt aktiviteti fushën e zgjedhjeve, sjellim në vëmendje që ky është një hap më tej dhe një hap përpara në këtë proces. Por nga ana tjetër do të duhet të ritheksojmë faktin se nuk është i plotë ndryshimi i

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit Rregullator
Dt. 21.12.2024*

kufizohet kjo? Ligjvënësi ka parashikuar në nenin 91 dhe nenin 92 dhe neni 91 ka identifikuar disa çështje, disa problematika, disa aktivitete, të cilat janë të ndaluara për t'u kryer në periudhën katër muaj përpara zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve. Në gjykimin tim personal nëse do të kemi një reformë të plotë zgjedhore kjo nuk do të duhej katër muaj, do të duhej minimalisht që në datën e dekretimit të zgjedhjeve dhe deri në datën e zgjedhjeve, edhe kësaj mund t'i shpëtojnë qeveritë pasi normalisht e programon buxhetin e saj vetëm për vitin e fundit zgjedhor. Megjithatë fakti që administrata konfirmon këtë gjë nga njëra anë, nga ana tjetër është për të ardhur keq që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk është prezent dhe nuk e konfirmon këtë gjë. Megjithatë unë jam i bindur që edhe në hipotezën se nuk do të kemi, së pari ne po i bëjmë një shërbim procesit zgjedhor me miratimin e këtij projektakti dhe së dyti, patjetër ne e kemi tagrin për të propozuar shtesa, ndryshime, sugjerime, të cilat ne si anëtarë të Komisionit Rregullator e shikojmë të nevojshëm për përmirësimin e këtij procesi. Nga ana tjetër unë do të doja dhe do ta diskutojmë dhe në vijim për shqyrtimin dhe miratimin e ndryshimeve përkatëse, do të doja të ndalesha në dy-tre propozime që ka bërë KRIIK-u, i kam lexuar me vëmendje, por do doja të ndalesha edhe në, do të doja një informacion shtesë nga administrata lidhur me konstatimet përkatëse, të cilat lidhen dhe me propozimet e KRIIK, konstatimet përkatëse të vendimeve të KAS lidhur me marrjen e masave administrative, për mungesën e raportimeve, raportimin jashtë afatit apo raportimin pa objekt dhe pa qëllim. Kur të vijë momenti konkret do të diskutojmë. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 21.12.2024*

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Çakaj! Diskutime të tjera në parim kemi? Kalojmë në votimin në parim të projektvendimit!

Kush është dakord kolegë?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Fillojmë me shqyrtimin nen për nen. Atëherë, në mbështetje të neneve 20, pika 1, shkronja "c", 91 dhe 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator, vendosi:

Në tekstin e Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

Znj. H. Vukaj: Mund të ndërhyj për një propozim që i paraprin nenit 2?

Znj. I. Nano: Po!

Znj. H. Vukaj: Në kuadër të përmirësimit dhe rritjes së efektivitetit për atë që synon KQZ në këto shtesa dhe ndryshime, do të thoja që nuk do të ishte i plotë ky propozim pa e atashuar dhe pa e nxitur procesin me parimet të cilat dikton Kodi i Procedurës Administrative, si pjesë determinuese, apo bazë ligjore e gjithë veprimtarisë që ushtron KQZ. Unë gjej me vend të propozoj që në aktin ekzistues, pas nenit 1 që flet për objektin dhe qëllimin, të shtojmë nenin 2 me titull "Parime të Përgjithshme", ku të rendisim:

Parimin e ligjshmërisë;

Parimin e transparencës dhe informimit;

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 21.12.2024*

Parimin e drejtësisë, paanësisë dhe objektivitetit;

Parimi i sigurisë dhe përgjegjësisë për moskeqpërdorim të veprimtarive publike, dhe
Parimi i kontrolli.

Për secilën nga parimet, unë kam draftuar përmbajtjen e secilit, po e lexoj:

Pra, 1. Parime të përgjithshme.

1. Parimi i ligjshmërisë: Procesi i raportimit të të gjithë veprimtarive me karakter..., në fakt procesi i raportimit dhe ushtrimit të veprimtarisë, apo me raportimin nënkuptojmë edhe pjesën tjetër të mosushtrimit, ose keqpërdorimit. Këtë mund ta sistemojmë edhe mes diskutimit. Për sa kohë raportimi lidhet jo vetëm me veprimtaritë e ndaluara, por dhe me qenien të kornizuar dhe të kujdesshëm nga ana e institucioneve për mosushtrimin dhe keqpërdorimin e tyre, përveçse t'i ekspozojnë.

Pra, ky është konteksti. Po i qëndrojmë atij draftimit të mëhershëm. Pra,

Parimi i ligjshmërisë: Procesi i raportimit të të gjithë veprimtarive me karakter publik nga institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve është detyrim ligjor. KQZ ka përgjegjësinë dhe detyrimin ligjor të mbikqyrë dhe shqyrtojë ato.

2. Parimi i transparencës dhe informimit: të gjitha institucionet publike të çfarëdo niveli dhe çdo ent tjetër që kryen veprimtari publike kanë përgjegjësinë e raportimit, me transparencë dhe objektivitet për të gjitha veprimtaritë me karakter publik, brenda afateve të ligjit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve zhvillon procesin e monitorimit dhe vlerësimit me transparencë dhe e bën atë publik.

3. Parimi i drejtësisë, paanësisë dhe objektivitetit: KQZ zhvillon procesin e vlerësimit të detyrimit për raportim dhe çdo denoncim të mbërritur në KQZ mbi bazën e parimit të drejtësisë, paanësië dhe objektivitetit. Gjithashtu KQZ duhet t'i

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 21.12.2024*

japë rëndësinë e duhur të gjithë informacioneve të ardhura në KQZ nga të tretë dhe subjektet politikë.

4. Parimi i sigurisë dhe i përgjegjësisë për mos keqpërdorim të veprimtarive publike: Të gjithë institucionet publike qendrore e vendore, që ushtrojnë veprimtari të karakterit publik si dhe KQZ e administrata e saj respektojnë të gjitha rregullat normuese që kanë të bëjnë me procesin e njoftimit të veprimtarive publike sipas afateve kohore të vendosura në Kodin Zgjedhor dhe kryejnë të gjitha procedurat që lidhen me këtë detyrim ligjor, me përgjegjësi e në përputhje me legjislacionin përkatës.

5. Parimi i kontrollit: detyrimi për raportim në kohë i veprimtarive publike dhe procesi respektiv, i nënshtrohet kontrollit administrativ, kontrollit gjyqësor dhe çdo kontrolli tjetër në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kaq ishin parimet.

Znj. I. Nano: Propozimi i zonjës Vukaj sapo u lexua, bëhet fjalë për një nen 2, që është... Pas nenit 1, shtohet neni 1/1 me titull “Parime të Përgjithshme” me përmbajtjen që sapo u lexua nga zonja Vukaj. Kolegë, kalojmë në votimin e këtij propozimi.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!


Miratohet me 5 vota pro!

Atëherë, Në nenin 2, pas pikës “a” shtohen pikat “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”, me përmbajtjen si më poshtë:

b. “Institucion publik”, konsiderohet çdo organ apo ent publik në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 21.12.2024*

shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.

c. “Veprimtari publike” janë të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikohen të zhvillohen në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve, deri ditën e zgjedhjeve, dhe që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut dhe/ose të medias, ose pasqyrohen nëpërmjet mjeteve të tjera të komunikimit dhe të informimit publik, si të tilla por pa u kufizuar, media online, rrjete sociale, faqe interneti, etj, të kryera nga subjektet e përcaktuara në këtë vendim. Janë gjithashtu veprimtari të tilla dhe ato që kanë në agjendë informimin në periudhën katër mujore para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

d. “NRI” është ndërfaqja elektronike e raportimeve të institucioneve publike e cila ndërtohet dhe shërben sipas përcaktimeve të nenit 92, të Kodit Zgjedhor.


e. Personi përgjegjës për raportimin është Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, sekretari i përgjithshëm i ministrisë, nëpunësi me hierarkinë më të lartë në bashki, drejtori i përgjithshëm apo drejtuesi më i lartë administrativ për agjensitë dhe institucionet nën varësinë e Këshillit të Ministrave, drejtuesi ekzekutiv i shoqërive tregtare në të cilat shteti ka pjesëmarrje në më shumë se 50 përqind të aksioneve, drejtuesi ekzekutiv i ndërmarrjeve shtetërore.

f. “Raportim” është veprimi i informimit të KQZ nga institucioni publik mbi veprimtarinë publike të këtij të fundit, sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim.

g. Veprimtaria publike duhet të raportohet nga personi përgjegjës për raportimin, në përputhje me parashikimet e këtij vendimi.

h. Raportimi i veprimtarive publike bëhet në KQZ nëpërmjet NRI e cila ndërtohet dhe mirëmbahet nga ky institucion.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 21.12.2024*

i. Të dhënat mbi aktivitetet publike të administratës shtetërore, apo të institucioneve publike duhet të jenë të aksesueshme, “open data,” për këdo të tretë, direkt nga NRI, duke patur mundësinë e prodhimit të raporteve përkatëse. Informacioni që përmban NRI është i aksesueshëm nga momenti i hedhjes së të dhënave deri në datën e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.

Në nenin 2, pika “c” bëhet pika “e” me përmbajtje si më poshtë:

e. “Kodi Zgjedhor”, është ligji nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Për këtë nen zoti Çaka, më ka kërkuar fjalën për një ndërhyrje.

Z. D. Çaka: Po faleminderit zonja Kryetare! Duke pasur parasysh që ky nen ka të bëjë kryesisht me pjesën e përkufizimeve, po të shohim në gjithë renditjen e pikave të cilat janë propozuar nga Komisioneri, bëhet fjalë kryesisht përkufizimi i “institucionit publik”, “veprimtari publike”, “NRI”, “personi përgjegjës për raportim”, apo vetë termi “raportim”. Në tre pikat e fundit, po themi janë tre normime që kanë të bëjnë në vlerësimin tim, jo me përkufizime, por me procedurën e raportimit. Pra pika “g” ku thotë “Veprimtaria publike duhet të raportohet nga personi përgjegjës për raportimin, në përputhje me parashikimet e këtij vendimi. Raportimi i veprimtarive publike bëhet në KQZ nëpërmjet NRI e cila ndërtohet dhe mirëmbahet nga ky institucion. Të dhënat mbi aktivitetet publike të administratës shtetërore, apo të institucioneve publike duhet të jenë të aksesueshme, “open data, ...”. Pra, këto tre pika nuk kanë të bëjnë me përkufizimin dhe unë propozoj që këto tre pika mund të akomodohen dhe mund të jenë pjesë e nenit 5, që është procedura e raportimit dhe të akomodohen te kjo pjesë. Ndërkohë brenda këtij akomodimi, pra këtij ndryshimi, te pika “h” e draftit që do të kalojë në pikën 5 në propozimin tim, ku thuhet “Raportimi i veprimtarive publike bëhet në KQZ nëpërmjet NRI e cila

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 21.12.2024*

ndërtohet dhe mirëmbahet nga ky institucion”, unë propozoj të zëvendësohet termi “nga ky instuticion” me termin “KQZ”.

Znj. I. Nano: Propozimi i parë është për t’i hequr këto tre pika dhe për t’i kaluar te pika 5 dhe kur të vijmë te pika 5, t’i shqyrtojmë.

Z. D. Çaka: Po!

Znj. I. Nano: Po zoti Çakaj!

Z. M. Çakaj: Kisha dhe unë një diskutim, jo propozim. Te pika “e” kemi dhënë përkufizimin e personit përgjegjës për raportimin, e cila është përshtatur si përcaktim nga Kodi Zgjedhor. Në propozimin që ka bërë KRIIK është evidentuar fakti që kemi dy persona që do të duhet të bëjmë së pari, përkufizimin dhe së dyti kanë dy procese. Personi përgjegjës për raportimin i cili është nëpunësi më i lartë kryesisht titullari, nëpunësi më i lartë i ekzekutivit i një institucioni. Kemi dhe personin, operatorin, i cili operon në ndërfaqe. Në rastin konkret NRI. Tani cili është vështrimi juaj dhe mendimi juaj në raport me këtë propozim, apo në raport me mënyrën se si operohet?

Znj. P. Doçaj: Duke qenë se një pjesë të mirë të rekomandimeve që KRIIK na ka sjellë, patjetër që ne i kemi marrë në konsideratë dhe i kemi adresuar edhe kur kemi përpiluar mënyrën se si do të funksionojë NRI. Ky është një nga ato rastet kur ne mendojmë se personi përgjegjës duhet të jetë ai person i ngarkuar nga ligji. Duke qenë se dhe në rast se do të kishte sanksione, pra do të shkelej ligji nuk e sanksionon personin e autorizuar, por do të sanksiononte gjithësesi sekretarin e përgjithshëm, drejtorin ekzekutiv. Pra, është i vetmi person që duhet të ketë akses në ndërfaqe dhe

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 21.12.2024*

është i vetmi person që do të sanksiononte ligji dhe është i vetmi person që është përgjegjës. Nëse do të kishte një person të autorizuar, që patjetër për shkak të facilitetit që do të krijonte, personi i autorizuar është ai që hedh të dhënat.

Z. M. Çakaj: Po operatori që plotëson ndërfaqen.

Znj. P. Doçaj: Duhet të rakordojë institucioni, pra sekretari i përgjithshëm me personin e autorizuar...

Z. M. Çakaj: Qartë, qartë!

Znj. P. Doçaj: Nuk është një marrëdhënie që mund ta adresojmë ne. Ne na ngarkon ligji me...

Znj. I. Nano: Për KQZ-në, i rëndësishëm është personi përgjegjës sipas ligjit.

Z. M. Çakaj: Për KQZ-në marrëdhënia me ndërfaqen...

Znj. P. Doçaj: Është marrëdhënia e drejtë për drejtë...

Znj. I. Nano: Është personi përgjegjës.

Z. M. Çakaj: Atëhere, ka pasur vendime të KAS në rastet kur nuk është evidentuar si përgjegjës personi përgjegjës i ngarkuar në vendimin nr. 9, apo nga neni 92 i Kodit Zgjedhor, por është sanksionuar operatori i cili nuk e ka ngarkuar? Ose hipotetikusht mund të ndodhemi përballë një situatë të tillë: personi përgjegjës për raportimin

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 21.12.2024*

autorizon operatorin, një përgjegjës sektori, një specialist të raportojë ndërfaqen. Mund ta ketë dhe me shkrim, vijinë provat këtu që ai e ka bërë. Në rastin konkret, në dijeninë tuaj, a ka ndonjë vendim të KAS që është mbajtur përgjegjës operatorin dhe jo personi përgjegjës?

Znj. P. Doçaj: Nga të dhënat që unë kam dhe ua kam vënë dhe në dispozicion në emailin e dërguar, nëse mund ta bëjmë me filtrim, mund të themi vetëm te pjesa e funksionarit publik, do të gjejmë që institucioni, apo personi që ka marrë gjobën nga KSHZ, më saktë i është propozuar KAS-it, janë drejtorë bashkie, sekretarë të përgjithshëm, kryetarë bashkie, drejtor ekzekutiv. Pra, në një vështrim të shpejtë të kësaj table. Në rast se do të kishte ndonjë rast të tillë, do të më duhet ta verifikoj, por normalisht në zbatim të ligjit do të duhet që detyrimisht të jetë sekretar i përgjithshëm.

Z. M. Çakaj: Qartë, jo, jo, dakord, dakord! Ju propozoni dhe ...

Znj. P. Doçaj: Më falni, edhe nga pikëpamja administrative do të ishte më e thjeshtë të kemi një person përgjegjës që raporton, që të kishte një llogari ai që raporton se do të kishte dhe për të kontrolluar...

Z. M. Çakaj: Po, po jam i qartë. Pra, në çdo rast personi përgjegjës për raportimin, do të jetë personi përgjegjës i cili do të ndërveprojë me faqen e KQZ-së dhe në rast shkelje të këtyre detyrimeve, do të jetë personi i vetëm përgjegjës. Pra, ky do të jetë qëndrimi edhe i KSHZ, edhe i Komisionit Rregullator. Mos ta ndajmë përgjegjësinë, ose mos ta shmangim përgjegjësinë. Dakord, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 21.12.2024*

Znj. I. Nano: Dakord! Atëherë, kemi një ndryshim të propozuar nga zoti Çaka për heqjen e pikës “g”, “h” dhe “i” kështu që më duhet ta votoj nenin pa këto tre germa të cilat do t’i shohim te pika 5.

Kush është dakord kolegë?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

2. Neni 4, ndryshohet si më poshtë vijon: Neni 4 Regjistrimi i Subjekteve në Ndërfaqen Elektronike të Raportimit të Institucioneve (NRI)

1. Ndërfaqja Elektronike e Raportimit të Institucioneve (NRI) përfaqëson faqen zyrtare të internetit të zotëruar dhe në shërbim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe të institucioneve të tjera për ushtrimin e detyrave e të përgjegjësive ligjore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe në këtë vendim. Ndërfaqja krijohet, administrohet dhe përditësohet nën autoritetin dhe përgjegjësinë e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

2. Çdo institucion publik krijon një llogari të vetën në NRI.

3. Llogaria në NRI krijohet personalisht nga personi përgjegjës për raportimin.

4. Për krijimin e llogarisë personi përgjegjës ngarkon në NRI, numrin e tij personal të identifikimit, datëlindjen, pozicionin që ka në strukturën administrative të institucionit publik, numër telefoni mobile, adresë email, dokumentin e identifikimit të skanuar, si dhe versionin e skanuar të autorizimit të lëshuar nga drejtuesi i institucionit publik, si person përgjegjës për raportimin.

5. Në momentin e krijimit të llogarisë në NRI personit përgjegjës i shkon në numrin e tij mobile një kod numerik për të autentifikuar kërkesën për hapjen e llogarisë përkatëse.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së,
Komisionit Rregullator
Dt. 21.12.2024*

6. Institucioni publik është përgjegjës për të dhënat që ngarkon në NRI dhe në tërësi për mbajtjen dhe administrimin e llogarisë.

Kolegë, është ripunuar i gjithë neni 4 nga vendimi nr. 9. Keni ndonjë diskutim?

Kalojmë në votimin e nenit 4, kolegë

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, zgj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Shkojmë te pika 3 e këtij projektvendimi.

Neni 5, ndryshohet si më poshtë vijon:

Neni 5. Procedura e raportimit në NRI. Unë po lexoj siç është propozuar dhe pastaj me zotin Çaka të gjejmë ku do të vendosim tre pikat që u zhvendosën nga neni tjetër.

1. Raportimi në NRI për një veprimtari publike të caktuar duhet të bëhet jo më vonë se pesë ditë përpara datës së planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë. Raportimi bëhet për veprimtari të cilat organizohen, ose bashkorganizohen nga institucioni publik raportues. Nuk raportohen veprimtari ku institucioni publik, apo përfaqësues të tij janë ftuar për të marrë pjesë.

2. NRI mund të lejojë raportimin e një veprimtarie e cila nuk plotëson kushtin e pikës 1 të këtij Kreu, por automatikisht kjo veprimtari përcaktohet si e ndaluar për sa kohë KSHZ nuk ka marrë një vendim për ta lejuar atë.

3. Raportimi duhet të përmbajë datën dhe orën e zhvillimit të veprimtarisë, qarkun, bashkinë, adresën ku ajo zhvillohet, llojin e saj, tematikën e veprimtarisë, emër mbiemër të personave pjesëmarrës të cilët përfaqësojnë nivelin më të lartë hierarkik shtetëror në aktivitetin përkatës, institucionin të cilit i përkasin, emër mbiemër të folësve të mundshëm dhe pozicionin e tyre, me pjesëmarrje të medias ose jo, pasqyruar në rrjete sociale, median online, ose jo.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 21.12.2024*

4. Të dhënat e raportimit nuk mund të modifikohen për periudhën pesë ditë përpara datës së zhvillimit të aktivitetit deri në datën e zhvillimit të tij.

Atëherë, zoti Çaka, që të dijmë për nenin 5 si do ta strukturojmë.

Z. D. Çaka: Unë do të propozoja që pika e parë e nenit pesë të bëhet pika “g” e nenit të mëparshëm. Pra, të niste me këtë formulim “veprimtaria publike duhet të raportohet nga personi përgjegjës”. Pika 2 e nenit 5 të ishte “Raportimi i veprimtarive publike bëhet nga KQZ nëpërmjet NRI”. Në vlerësimimin tim, mendoj që të vazhdonte pastaj me katër pikat ekzistuese të nenit 5 dhe pika “i” që janë të dhënat të ishte pika e fundit e nenit 5.

Znj. I. Nano: Dakord! Atëherë keni përmbajtjen sikundër keni dhe propozimin e zotit Çaka. Atëherë, zoti Çakaj!

Z. M. Çakaj: Atëherë, kisha dhe unë, një diskutim dhe një propozim. Në pikën ekzistuese nr. 2 që sipas propozimit të kolegut Çaka të bëhet pika 3, ka një propozim nga KRIIK. “NRI mund të lejojë raportimin e një veprimtarie e cila nuk plotëson kushtin e pikës 1 që është afati pesë ditor të këtij Kreu, por automatikisht kjo veprimtari përcaktohet si e ndaluar për sa kohë KSHZ nuk ka marrë një vendim për ta lejuar atë”. Për ta sqaruar, në gjykimin tim autoritetet, instucionet nuk duhet të pengohen për të raportuar një veprimtari. Sigurisht do të mbetet në diskrecionin e KSHZ për ta vlerësuar nëse është e ndaluar apo jo, për ta trajtuar. Pra, për t’i dhënë vlerësimin objektiv se në varësi të rrethanave, fakteve, apo provave se përse është raportuar me vonesë kjo. Ky është gjykim personal për më tepër le të thonë kolegët. Ndërsa në lidhje me pikën 3 ekzistuese përsëri është një rekomandim i KRIIK që përsëri, unë e gjej me vend, propozohet që të vendoset si pikë 4 pas propozimeve të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 21.12.2024*

zotit Çaka të rirenditet si pikë 4. Pra, krahas të dhënave që duhet të përmbajë raportimi, datën, orën e zhvillimit, qarkun, bashkinë, adresën, llojin, tematikën, këtu të shtohet dhe qëllimi i veprimtarisë. Në gjykimin tim, një nga problematikat kryesore që ka hasur edhe KSHZ, por kryesisht KAS në shqyrtimin e ankimeve dhe hetimeve është se nuk është përcaktuar qëllimi dhe kjo adreson shumë probleme dhe ne na zgjidh, si dhe kolegëve të KAS-it, por ne na zgjidh atë merakun dhe është përmirësim i atij procesi. Pra, cili është qëllimi i realizimit të veprimtarisë që po raportohet. Kaq kisha, e Nderuar!

Znj. I. Nano: Atëherë, si propozime konkrete kemi që në pikën 3 ekzistuese, 5 me rirenditjen “tematikën dhe qëllimin e veprimtarisë”, ky është një propozim. Kemi dhe propozimin e zotit Çaka që të rirenditet “g”, “h” dhe më pas “i”. I votojmë në bllok këto dy propozime, pra nenin 5 me propozimet? Kolegë,

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Vazhdojmë me tej.

4. Neni 9, ndryshohet si më poshtë vijon:

Neni 9. Shqyrtimi i Raportimeve dhe ndalimi i veprimtarive publike.

1. KQZ shqyrton raportimet e institucioneve si rregull jo më vonë se 3 ditë nga raportimi i tyre në NRI.

2. Në rast se KQZ, kryesisht ose me kërkesë të të tretëve, konstaton se veprimtaria publike përbën veprimtari të ndaluar, urdhëron ndalimin e zhvillimit të veprimtarisë publike përkatëse. Ndalimi kryhet nëpërmjet vendosjes së shënimit “Ndaluar nga

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 21.12.2024*

KQZ-ja” në NRI, në pjesën që i takon veprimtarisë. Njoftimi për ndalim i shkon automatikisht institucionit në llogarinë e tij në NRI.

3. Personat e tretë që paraqesin kërkesën në KQZ për të kërkuar ndalimin e një veprimtarie publike, duhet ta paraqesin atë jo më vonë se tre ditë nga data e planifikuar e mbajtjes së tij. Kërkesa paraqitet në protokollin e KQZ, ose nëpërmjet adresës zyrtare të emailit dhe duhet të jetë e arsyetuar. KQZ shqyrton kërkesën dhe vendos në lidhje me të brenda 24 orësh nga paraqitja e saj.

4. Për veprimtarinë ose aktivitetin publik “Ndaluar nga KQZ-ja”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve njofton menjëherë zyrtarisht edhe Autoritetin e Mediave Audiovizive. Veprimtaritë e ndaluar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk lejohen të transmetohen apo të pasqyrohen në rubrikat e lajmeve apo ato që mbulojnë fushatën në radio dhe televizione. Transmetimi ose pasqyrimi i tyre në kundërshtim me ndalimin e vendosur nga Komisioneri ngarkon me përgjegjësi transmetuesin radioteleviziv.

5. Mosraportimi i një veprimtarie publike, ose raportimi i saj në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në këtë vendim, apo akte të tjera, apo pengimi për raportim, ngarkon me përgjegjësi personin përgjegjës në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor. Shqyrtimi administrativ në këtë rast bëhet në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe aktet e KQZ.

Një pyetje, te pika 3 personat e tretë që do të paraqesin kërkesën në protokoll, apo në adresën zyrtare të emailit..., adresë zyrtare e kujt është kjo? E personave të tretë, apo është ndonjë adresë e dedikuar?

Znj. P. Doçaj: Adresë emaili i KQZ “*info.kqz...*”.

Znj. I. Nano: Të saktësohet kjo, se nuk kuptohet. Po zonja Vukaj!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 21.12.2024*

Znj. H. Vukaj: Këtë e ezauruat ju, unë kam një moment tjetër te pika 4, në fund të pikës tek fjalia e fundit... pra, “Transmetimi ose pasqyrimi i tyre në kundërshtim me ndalimin e vendosur nga Komisioneri ngarkon me përgjegjësi transmetuesin radioteleviziv.” Çfarë keni parasysh me “transmetuesin”? Mos është personi i ngarkuar me transmetimin?

Znj. P. Doçaj: E kemi fiks të marrë nga... pra, është pika 5 e nenit 92, ku është e përcaktuar pikërisht me këtë term, transmetimi ose pasqyrimi i tyre në kundërshtim me këtë pikë, ngarkon me përgjegjësi sipas këtij ligji, transmetuesin radioteleviziv. Pra, për ato që KQZ ka dhënë njoftimin se është e ndaluar, e ka dërguar tek “AMA”...

Znj. H. Vukaj: E kam shumë të qartë dispozitën, por për efekt të zbatueshmërisë dhe sensibilitetit, do të duhet patjetër një shpjegim se çfarë përbën transmetuesi, me qëllim që të dihet fasha e personave që ngarkohen me përgjegjësi, sepse transmetues mund të jetë komplet një individ, ose një person tjetër përgjegjës nga ai që në të vërtetë përbën atë që quhet transmetues. Pra, personi përgjegjës që lidhet me transmetimin, ose pronari i medias?

Z. M. Çakaj: Personi juridik!

Znj. I. Nano: Personi juridik, transmetuesi, pastaj se si e kanë...

Znj. H. Vukaj: Mirë, mirë, por ndaj e doja nga administrata, sepse administrata do të jetë që do ta zbatojë në fund të fundit.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 21.12.2024*

Znj. I. Nano: Kujt i janë akorduar gjoba? Subjekteve, personave juridikë që janë transmetues.

Znj. H. Vukaj: Pra, ju keni parasysh subjektin në këtë rast?

Znj. P. Doçaj: Po, po!

Znj. H. Vukaj: Këtë për sqarim për publikun.

Znj. I. Nano: Dakord! Thamë të shtojmë këtë “adresën zyrtare info”, që të dihet. Nuk kemi diçka tjetër. Kalojmë në votimin dhe të këtij neni.

Kush është dakord kolegë?

Pro: 5 (z. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, z. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Do të duhet të shtojmë dispozita të fundit, si kre...

Z. M. Çakaj: Ne kemi vendosur një standard. Kreu V “Dispozita të fundit” ku kemi parashikuar që...

Znj. I. Nano: Hyn në fuqi menjëherë...

Z. M. Çakaj: Së pari, hyrja në fuqi,

Znj. I. Nano: Fillimisht është “ngarkohen me zbatimin...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 21.12.2024*

Z. M. Çakaj: “Po fillimisht është “Ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi KQZ dhe të gjitha instuticionet publike sipas përkufizimit në këtë vendim”. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, çdo akt nënligjor ... në fakt shfuqizohen të gjithë...”

Znj. I. Nano: Jo, jo, s’ka gjë, i kemi shfuqizuar! Sa kohë kemi miratuar ndryshimet i kemi ...

Z. M. Çakaj: Po, po ky është ndryshim.

- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

Znj. I. Nano: Pra jemi te Kreu V “Dispozita të fundit”, me tre pika. Atëherë kolegë, **Kush është dakord kolegë?**

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pasi kemi miratuar në parim, kemi shqyrtuar dhe miratuar nen për nen projektvendimin i cili ka pësuar dhe disa ndryshime...

Znj. H. Vukaj: Më falni zonja Nano, të marr dhe një përgjigje nga administrata për një rikonfirmim tërësor edhe më të plotë të asaj që parashtrova, nga Komisioneri. A do të jemi në të njejtat kushte, apo do të kemi..? Cila është përgjigjja e tij?

Znj. I. Nano: Zonja Çelmeta ju lutem!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 21.12.2024*

Znj. M. Çelmeta: Lidhur me deklaratën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, përgjigjja e tij është që “mbaj të njëjtin qëndrim me zonjën Doçaj”. Pra, punë është në vijim e sipër!

Znj. H. Vukaj: Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Çelmeta! Kalojmë në miratimin në tërësi të projektvendimit. Kolegë,

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kjo ishte çështja që kishim në rendin e ditës, e rëndësishme pa dyshim! Nuk kemi çështje të tjera, kështu që mbledhjen e deklaroj të mbyllur, faleminderit!

Vendimi nr. 16

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

